



Oda e Stomatologëve të Kosovës

Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

| | |
|------------------------|---|
| DATA/DATUM/DATE: | 27.01.2021 |
| PËR/ZA/TO: | Z. Armend Zemaj, Ministër në detyrë i Shëndetësisë |
| NGA/OD/FROM: | Prof.Dr. Blerim Kamberi, Kryetar i Odës së Stomatologëve të Kosovës |
| Cc: | Z. Ardian Mehmetaj, UD i sekretarit të përgjithshëm MSH Dr. Labinot Shahini, kryetar i BQSHS |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Kërkesë për mbështetje financiare të specialistëve të rinj të stomatologjisë nga programi i subvencioneve |

I nderuar Ministër në detyrë Z. Zemaj,

Në adresën e Odës së Stomatologëve të Kosovës ka ardhur një kërkesë prej një grupi të specializantëve të stomatologjisë, të cilët janë të kyçur në programin e edukimit specialistik në Qendrën Klinike Stomatologjike Universitare të Kosovës, dhe të cilët kërkojnë të përfshihen në financim nga programi për subvencion.

Si Kryetar i Odës së Stomatologëve të Kosovës është obligimi im të angazhohem në promovimin e veprimtarisë së profesionistëve shëndetësorë-stomatologëve në institucionet shëndetësore publike dhe private si dhe të përfaqësoj dhe mbroj interesat profesionale të anëtarëve të Odës në ushtrimin e profesionit (Ligji Nr, 04/L-150, neni 2 dhe neni 10 paragrafi 1).

Andaj në cilënë e Kryetarit të Odës së Stomatologëve të Kosovës, jap pëlqimin dhe i mbështesë grupin e specializantëve të stomatologjisë të cilët janë me vetëfinancim të përfshihen në financim nga programi i subvencioneve, program ky që i ka mbështetur edhe më herët specialistat e lëmive të mjekësisë dhe stomatologjisë.

Të gjithë specialistët e rinj janë anëtarë të Odës së Stomatologëve të Kosovës dhe kanë licenca valide të punës për të ushtruar profesionin e stomatologut në Republikën e Kosovës.

Jemi të gatshëm si Odë e Profesionistëve Shëndetësorë të japim kontributin tonë në shërbim të zgjidhjes së kësaj çështjeje.

Faleminderit për mirëkuptim!

Me respekt,

Prof. Dr. Blerim Kamberi

Kryetar i Odës së Stomatologëve të Kosovës

